



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:006377

Datë: 06.05.2022

Numri i dokumentit: 02987061

PKR.nr.7/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetar i trupit gjykues-gjyqtari Mentor Hajraj, me zyrtare ligjore Shqipe Sejdiu, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.F, për shkak të veprave penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe Përdorimi i armës apo mejetepit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.30/2020, të datës 19.01.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.14.04.2022, e cila ka qenë e mbyllur për publikun në respektim të masave anti covid-19 ku kanë prezantuar i pandehuri G.F dhe Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, me datë 14.04.2022, ka marrë dhe me pas publikisht ka shpallur, ndërsa me datë 05.05.2022, ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: G.F, nga i ati /, e ëma /, e gjinisë /, i lindur me / në fshatin /, komuna e Mitrovicës, ku edhe banon, me profesion bukëpjekës në furrën “/” në Mitrovicë, i martuar, baba i / fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit /.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I. Prej datës së pa caktuar e gjer me datën 25.02.2020, rreth orës 21:30 në fshatin Begaj, të vendi i quajtur “Gorollak”, i pandehuri ka mbajtur në posedim armën pa leje përkatëse, e në kundërshtim me ligjin për armët (Ligji nr. 5/ L-22), me ç’rast tek i pandehuri nga ana e zyrtareve policor e gjejnë armen me gaz e tipit Ekol Special 99, Cal 90 mm P.A.K, me numër serik EU18090262, një karikator, tri gëzhoja dhe dy fishek.

Me këtë ka kryer veprën penale **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**

II. Me datën 25.02.2020, rreth orës 21:30 në fshatin Begaj, të vendi i quajtur “Gorollak” , i pandehuri përdor armën me gaz të tipit Ekol Special 99, Cal 90 mm P.A.K, me numër serik EU18090262, duke shtënë tri herë në ajër.

Me këtë ka kryer veprën penale **Përdorimi i armës apo mejtepit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale nën pikën I të dispozitivit.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 366 par.1 dhe 367 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenet 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së:

S H Q I P T O N

Për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilin dënim obligohet t’u paguaj në afat prej 90 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale Përdorimi i armës apo mejtepit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej dy (2) viteve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale.

Në rast së i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim duke llogaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë të kaluar në burg.

Gjykata në mbështetje të nenit 366 par. 3 të KPP-së, të pandehurit i konfiskohet arma- pistoletat me gaz e tipit Ekol Special 99, Cal 90 mm P.A.K, me numër serik EU18090262, një karikator, tri gëzhoja dhe dy fishek, ashtu që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se arma është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 10€ (dhjetë euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.61/2020, të datës 10.11.2020, ndaj të pandehurit G.F, për shkak të veprave penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe Përdorimi i armës apo mejtepit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 14.04.2022, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, i pandehuri G.F, ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, më pas i pandehuri është deklaruar se e kupton akuzën dhe veprat penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pasi që është njoftuar për pasojat dhe benificionet që parasheh ligji lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet, pranimin e fajësisë e bëjë në mënyrë vullnetare, ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmë nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me deklarin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e cili ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që këtë pranim e ka bërë në mënyrë vullnetare, i ka kuptuar pasojat e kryerjes së veprave penale pas sqarimit të gjykatës, kurse pranimin e fajësisë mbështetet edhe në provat tjera materiale, andaj propozoj gjykatës që t'ia pranoj fajësinë të pandehurit.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurorja e Shtetit, Kryetari trupit gjykues është bindur se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj Kryetari i trupit gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 248 par. 4 e lidhur me par. 1 të KPP-së, ka marrë aktvendim

duke pranuar pranimin e fajësisë, pasi që i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale.

Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga i pandehuri dhe më qenë se nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, Kryetari trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit dhe i ka njoftuar palët se gjykata do të vazhdojë në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së me shqiptimin e dënimit – respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë me datë 14.04.2022, shpallja ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti COVID-19, në prezencë të pandehurit ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i pandehuri në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, Gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të pandehurit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe Përdorimi i armës apo mejetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale nën pikën I të dispozitivit, me të cilat akuzohet sipas aktakuzës, kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës: Raportet policore; Dëshmia e dëshmitareve; Dëshmia e të pandehurit; Fotodokumentacioni; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 12.03.2020, Skica e vendit të ngjarjes, si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen-krijohen elementet e veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe Përdorimi i armës apo mejetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, të gjitha rrethanat si me lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të pandehurit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për të përjashtuar përgjegjësinë penale të të pandehurit në këtë çështje.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë

lehtësuese vlerësoj pranimin e fajësisë nga i pandehurit, shprehjen e keqardhjes se i pandehuri është penduar për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të tij.

Mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 366 par. 3 të KPP-së, të pandehurit i ka konfiskuar armët dhe atë: pistoleta me gaz e tipit Ekol Special 99, Cal 90 mm P.A.K, me numër serik EU18090262, një karikator, tri gëzhoja dhe dy fishek, ashtu që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se arma është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i pandehuri në kundërshtim ligjor me neni 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 Ligjin për Armët (Ligji Nr.05/L022), Gjykata duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu është sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet me lart, kjo në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par. 2 nën par. 2.1 të KPP-së, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh gjetjet e gjykatës lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 366 par. 3 të KPRK-së, përcakton *“Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”*, andaj për shkaqe ligjore të konstatuara me lart gjykata ka vendos si nën pikën III të këtij Aktgjykimi, që sendet e përdorura të merren–konfiskohen.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.7/2022, të datës 05.005.2022

Zyrtarja ligjore:

Shqipe Sejdiu

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së pranimi të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.